



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nr. Prot 107

Tiranë, më 2 Prill 2020

Drejtuar: **Znj. Etilda Gjonaj (Saliu)**
Ministre
Ministria e Drejtësisë

Për dijeni: **Z. Agim Ismaili**
Drejtor i Përgjithshëm
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Nga: **Znj. Erida Skëndaj**
Drejtore Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Lënda: *Përcillet kërkesë për realizimin e komunikimit përmes platformës Skype, ndërmjet të paraburgosurve/dënuarve dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit*

E nderuar Znj. Ministre,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) po ndjek me vëmendje masat e marra dhe rregullat e brendshme të aplikuara në institucionet penitenciare, në përgjigje të situatës së krijuar ndaj pandemisë botërore COVID-19.

Në komunikimin zyrtar të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB), më datë 13 Mars 2020, jemi vënë në dijeni se me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë ka përfunduar instalimi dhe lidhja e kompjuterave në 24 institucionet të cilët mundësojnë komunikimin përmes platformës “Skype”.

KShH shpreh vlerësim për këtë vendimmarrje të domosdoshme, e cila është në harmoni me masat parandaluese që qeveritë e vendeve evropiane kanë miratuar për parandalimin e përhapjes së virusit në sistemin e burgjeve dhe garantimin e respektimit të të drejtës së shtetasve të paraburgosur/dënuar për jetë private dhe familjare.

Në mungesë të njohjes me përmbajtjen e këtij urdhëri, me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të mekanizmit të kërkesë-ankesës për të dënuarit dhe të paraburgosurit, veçanërisht mekanizmi i jashtëm për ankesa dhe kërkesa,¹ KShH Ju përcjell kërkesën për krijimin e mundësive për realizimin e trajtimit të kërkesë-ankesave nëpërmjet platformës Skype. Itinerari kohor për realizimin e komunikimeve audio në Skype nëpërmjet të paraburgosurve/dënuarve dhe stafit të Klinikës Ligjore pranë KShH-së, çmojmë të përcaktohet nga ana e DPB-së.

¹ Parashikuar nga nenet 8, 11, 41, 49 të Ligjit nr. 8328, dt. 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar, si dhe nenet 43, 56 pika 9, 90, 130 të VKM nr. 437, dt. 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, mbetemi në pritje të një përgjigje pozitive zyrtare nga ana Juaj, me qëllim për të vijuar me përcjelljen në adresë të DPB-së së të dhënave të llogarisë së KShH-së në platformën Skype.

Me konsideratë,

Erida Skëndaj
Drejtoreshë Ekzekutive